



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 141/ 14
Prishtinë, më 29.01.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, Albana Fetoshi dhe Muhamet Musafa.

Munguan: Safete Hadergjona dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Aleksandra Fehinger dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga NDI.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Zëvendës kryetar i parë i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

- 1. Miratimi i rendit të ditës:**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura e Komisionit, dt. 22.01.2014:**
- 3. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2014:**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent me amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së:**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Naser Osmani: konstatoi se rendi i dites miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura e Komisionit, dt. 22.01.2014

Naser Osmani: konstatoi se miratohet procesverbali i mbledhjes se kaluar pa vërejtje.

3. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2014

Naser Osmani: thekson se në draft planin e punës për vitin 2014 janë paraparë një sërë aktivitetesh. Besojë se e keni shikuar planin dhe meqë është draft ne sot mund të bëjmë ndryshime, dhe duhet ta miratojmë dhe procedojmë më tutje. Ajo që ka mbetur të përcaktohen në komision është caktimi i ligjeve që do të monitorohen këtë vit. Përpara e keni një listë të ligjeve në fuqi dhe të fushës që mbulon komisioni. Unë mendojë njëri ndër ligjet që mund të monitorohet është ligji për TVSH-në.

Latif Gashi mendojë se një ligj i rëndësishëm që mund të futet në plan të punës është ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jobankare financiare. Po ashtu një ligj tjetër i rëndësishëm që mund të monitorohet është ligji për financat e pushtetit lokal.

Naser Osmani: sa i përket ligjit për bankat dhe institucionet financiare, ne e dijmë si është situata me këtë ligj. Kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese për ligjin në fjalë sa i përket qështjes së institucioneve mikrofinanciare dhe me që projektligji për institucionet mikrofinanciare është në strategjinë legjislative të qeverisë për këtë vit, të presim draftin që duhet të vijë nga qeveria dhe pastaj kemi mundësi të diskutojmë dhe shqyrtojmë.

Albana Fetoshi: vlerësoj të rëndësishëm që të monitorohet edhe zbatueshmëria e ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe propozoj që ky ligj të futet në plan të punës për vitin 2014.

Hykmete Bajrami: theksoi se do të ishte mirë të monitorohen të tri ligjet fiskale, si ligji për tatimin në të ardhurat individuale, ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar. I formojmë grupe më të mëdha dhe i monitorojmë të tri ligjet, pasi që janë të njëjtat institucione që duhet vizituar.

Naser Osmani: mendojë se duhet të përcaktohem për dy ligje dhe mos të propozojmë më shumë e pastaj të mos mund ti monitorojmë. Propozoj që për pjesën e parë të vitit të bëhet mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, ndërsa në pjesën e dytë të vitit ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Miratohet planin vjetor i punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2014, me dy plotësime: mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent me amendamentet e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerjen e FSK-së

Naser Osmani: në bazë të opinionit të ministrisë sponORIZuese dhe ministrisë së financave, shohim se projektligji përmban një kosto buxhetore shtesë që për vitin për vitin 2014 është vlerësuar në shumë prej 15,334, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 në shumë prej 13,334 euro. Këto mjete mund të përballohen nga ministria, pjesë e së cilës do të jetë edhe agjencia.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

Naser Osmani: njoftoj anëtarët sot është caktuar takimi i grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit. Pjesë e grupit punues janë anëtarët e njëjtë që kanë monitoruar ligjin. Pasi që anëtar i grupit punues për monitorim ka qenë edhe Sali Asllanaj dhe i njëjti nuk është më deputetë, propozojë që në vend të tij të jetë Xhevdet Neziraj. Po ashtu kam menduar që punën e grupit punues ta mbështesin dy ekspertë, njëri të financohet përmes buxhetit të komisionit dhe tjetri nga GIZ që e kemi mbështetjen për financim nga projekti që përkrah komisionin. Propozojë që si ekspert i jashtëm që do të paguhet nga buxheti i komisionit të jetë Ruzhdi Zenelaj, i cili do të merret më shumë me qështjet ekonomike në procesin e hartimit të projektligjit dhe Haxhi Gashi si ekspert që do të financohet nga GIZ dhe do të merret me natyrën juridike të hartimit të projektligjit. etj.

Në bazë të propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni njëzëri miratoi propozimin që pjesë e grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit, në vend të Sali Asllanja të jetë Xhevdet Neziraj.
- II. Komisioni vendosi të angazhoj dy ekspertë të jashtëm që do të ndihmojnë komisionin në procesin e hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit: Ruzhdi Zenelaj i cili do të paguhet nga buxheti i Komisionit dhe Haxhi Gashi që do të paguhet nga Projekti që mbështet komisionin – GIZ.

Hykmete Bajrami njoftojë anëtarët se me datë 6 dhe 7 shkurt 2014, është e ftuar në cilësinë e deputetës dhe do të marrë pjesë në një seminar të Rrjetit parlamentar të FMN-së dhe Bankës Botërore, që do mbahet në Vjenë. Të gjitha shpenzimet i mbulon organizatori dhe për këtë vizitë kam marrë leje edhe nga Kryetari i Kuvendit.

Mbledhja përfundoi: 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendës kryetar i parë i Komisionit

Naser Osmani